



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, , Kryetari i Komunes, nxjerr:

### VENDIM PËR ANULIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. ANULOHET, Vendimi i Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit 1Nr.112-26039/1 i datës 18.06.2015, përshkak të shfuqizimit të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015 nga e cila ka rrjedhur baza ligjore për marjen e Vendimit për formimin e këtij Komisioni.

II. Kërkesat eventuale të mbetura për shqyrtim që janë pranuar gjatë kohës që ka qenë në fuqi Rregullorja e kaluar, Komisioni është kompetent ti shqyrtojë dhe të nxjerrë Rekomandim për Kryetarin e Komunës më së largu me datë 10.02.2017.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

#### Arsyetim

Me datë 18.06.2015, Kryetari i Komunës ka nxjerrë Vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave të cilat i parashtrohen Kryetarit të Komunës për mbështetje financiare për renovimin apo ndërtimin e shtëpive për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike në përbërje: Remzi Mehmeti, Kryesues dhe anëtarët Hasan Zeqiri, Ymer Bikliqi, Albert Mustafa dhe Skender Gërbeshi .

Vendimi i lartëcekur anulohet pasi që është nxjerrë duke u bazuar në Rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015 e cila është shfuqizuar në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullores aktuale për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 pasi që i njëjti nuk mund të prodhojë më tutje efekte juridike pasi që tashmë i mungon baza ligjore .

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi u dërgohet për njoftim Kryesuesit dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit.

1Nr. 112-3408  
Lipjan, më 27.01.2017

